



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:136731

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06328500

C.nr. 176/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, sipas gjyqtarit Alush Sinani, në çështjen konstestimore të paditësit B.Z.nga Vitia, rruga "Flaka e janarit", kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit e papercaktuar, në seancën gjyqësore të datës 21.10.2024, bie këtë;

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësit B.Z.nga Vitia rruga "Flaka Janarit"pn, e paraqitur kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt konstesti, kompensim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit e papercaktuar, Konsiderohet e tërhequr

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi B.Z.nga Vitia, rruga "Flaka Janarit"pn, me datë 08.01.2019, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt konstesti, kompensim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit e papercaktuar.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore, për datën 18.10.2024, me fillim në ora 09:00/h, janë ftuar në mënyrë të rregullt palët ndërgjyqëse, mirpo, në seancë nuk ka prezentuar paditësi dhe mungesën nuk e kane arsyetuar, perkundër se ftesen e ka pranuar personalisht, në mënyrë të rregullt, me datën 17.09.2024, kjo konfirmohet ne baze te fletktheses për dorëzim personal.

Përfaqësusi me autorizim i të paditurës, B.M., është paraqitur në seancën e datës 18.10.2024, në ora 09:00/h, i njejt i ka theksuar se meqenëse paditësi, e ka pranuar ne menyre te rregullt ftesën per seance e sotme gjyqesore, mirpo nuk prezenton në seancë dhe mungesën nuk e kane arsyetuar, gjithashtu nuk e kanë njoftuar gjykatën per mungesën e tij, atëherë i propozoj gjykatës qe padinë e paditësit ta konsideron te tërhequr.

Meqenëse paditësi, me datë 17.09.2024, ka pranuar ftesën për seancën gjyqësore per daten 18.10.2024, me fillim ne ora 09:00/h, ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata, duke u bazuar në nenin 409, të LPK-së, në të cilin thuhet se "*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç*

kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”, padinë e paditëseve e ka konsideruar të tërhequr ndaj të paditurëve, andaj e vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Për shpenzimet e procedurës gjyqësore, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së. Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në 142 LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:136731, 18.10.2024
C.nr.176/2019**

Gjyqtari
Alush Sinani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.